

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses L. M., nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson L. B. nga Sindikata e Pavarur e PTK, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) në Prishtinë, të cilën e përfaqëson R. B., sipas autorizimit me shkrim, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr. 1394/2015 datë 19.7.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21 prill 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.1394/2015 datë 19.7.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr. 215/2012 datë 12.2.2015, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, ashtu që është anuluar aktvendimi i të paditurës nr.... datë 7.3.2012, dhe është detyruar e paditura që paditëses t'ia paguaj ndryshimin e pagës, bonusit dhe trustit në mes gradës 7 dhe 6, për periudhën nga data 1.2.2012 deri më 30.11.2014, në shumat mujore prej 102,25 €, në shumë të përgjithshme prej 3.229,71 €, si dhe për çdo muaj në vazhdimësi nga muaji dhjetor 2014 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, në shumat mujore bruto prej 102,25 €, edhe kamatën si për mjetet e deponuara në bankë për 1 vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e

arritjes për pagesë të pagave mujore, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 150 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.1394/2015 datë 19.7.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohen këto aktgjykime dhe kërkesëpapia e paditëses të refuzohet si e pabazuar, ose që të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka qenë e punësuar tek e paditura sipas kontratës së punës nr...., datë 20.10.2011, në vendin e punës teknik specialist në njësinë Telekomit i Kosovës në regjionin e Ferizajt. Me nenin 5 të kontratës është përcaktuar se të punësuarit i caktohet paga bazë për punë për të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 7, sipas vendimit të Bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK, nr. ..., datë 28.2.2005, së paku një herë në muaj, e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale. E paditura me vendimin e burimeve njerëzore nr..., datë 7.3.2012, paditëses i zbrit gradën e punës nga 7 në 6, duke filluar nga data 1.2.2012, e i cili vendim sipas të paditurës konsiderohet si pjesë përbërëse e kontratës së lartë përmendur të punës. Paditësja më datën 27.4.2012, i është drejtuar me padi gjykatës që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë diferencën kontestuese të pagës në tërësi sipas kontratës së punës.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesëpapia e paditëses është e bazuar, andaj detyroi të paditurën që paditëses t'ia paguajë diferencën e pagës në mes të gradës 7 dhe 6, në shumat e precizuara më afër si në dispozitiv

të aktgjykimit të saj, e cila lartësi e diferencës së pagës nuk është kontestuar nga e paditura, është kontestuar vetëm baza ligjore e saj. Sipas gjykatës së shkallës së parë, e paditura me zvogëlimin e gradës së punës për paditësen prej 7 në 6, në mënyrën e përshkruar më lartë, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e punës, pa marrë pëlqimin e paditëses për ndërrimin e kushteve të kontratës.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës, dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të saj. Për më tepër gjykata e shkallës së dytë gjen se ndërrimi i gradës në kundërshtim me kontratën e punës dhe pa pëlqimin e punonjësit si palë kontraktuese nuk mund të bëhet me një vendim të drejtorit menaxhues.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë dhe asaj të parë, lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditëses, pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër gjykata e revizionit vlerëson se aktgjykimet e lartcekura nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika n, të LPK, të cilat pretendime u refuzuan si të pabazuara, nga se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, përkundrazi të njëjtat janë të qarta, nuk përmbajnë të meta e paqartësi, në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme plotësisht edhe për gjykatën e revizionit.

Qëndron fakti se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit me çka për mes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin edhe pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Sipas të paditurës kërkesëpadia me të cilën paditësja ka kërkuar pagesën e diferencës kontestuese të pagës është vjetërsuar. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast paditësja nuk është vonuar me paraqitje të padisë nga se kontesti ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të paditurës, e për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës afati i parashkrimit është 3 vite, e jo siç pretendohet në revizion se afati për paraqitje të padisë për paditësin duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se i punësuari në pajtim me nenin 55 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Punës ka të drejtë në pagë e cila i caktohet me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditëses, sipas kontratës së punës, në pajtim me nenin 11.1.8 të Ligjit të punës ka qenë sipas gradës 7, prandaj ulja e pagës nën këtë gradë pa pëlqimin e paditëses është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës, dhe me dispozitat e lartë përmendura ligjore.

Për arsyet e paraqitura më lart , dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 90/2017, më 21 prill 2017

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani